



Lajmëtari zyrtar i Qytetit të

SHKUPIT

Numër:
pa pagesë

| Numër 15 | Viti III | 30.09.2010 |



**RRUGA "ILINDENSKA" U SHNDËRRUA
NË BULEVARD "ILINDEN"**

U lëshua në përdorim korridori i ri rrugor në qendrën e qytetit

RRUGA “ILINDENSKA” U SHNDËRRUA NË BULEVARD “ILINDEN”



Rruga e njohur “Ilindenska”, e cila për vite me radhë përbënte grykë të ngushtë në qendrën e qytetit, tanimë u la në të kaluarën. Pas shtatë muajsh punë ndërtimore për zgjerimin dhe rikonstruksionin e kësaj rruge javën e kaluar Shkupi u bë me një korridor të ri dhe të rëndësishëm rrugor. Rruga “Ilindenska”, u transformua në bulevard “Ilinden” nga kryqëzimi me bulevardin “Shën. Kliment Ohridski” deri në kryqëzimin me bulevardin “8 Shtetvri” me gjatësi 2.140 metra. Bulevardi ka nga dy korsi rrugore në çdo drejtim, trotuare të rregulluara dhe korsi për biçikleta, kryqëzime të reja, gjelbërim të gjelbër dhe ndriçim të ri. Qyteti i Shkupit e realizoi me sukses këtë projekt të ndërlikuar i cili është me vlerë 201 milion denarë ose rreth 3,3 milion euro.

Bulevardin “Ilinden”, zyrtarisht e

lëshoi në përdorim kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski dhe kryeministri Nikolla Gruevski, më datën 21 shtator.

- Është kënaqësi e veçantë për mua që pikërisht sot, kur festojmë Shën. Marinë-Mbrojtësen e Shkupit, të kem nderin të shpall fundin e njërit prej projekteve më të mëdha të bëra në qytetin tonë 12 vitet e fundit në territorin e qendrës së qytetit dhe t’ua jap në përdorim zyrtarisht bashkëqytetarëve të mi bulevardin “Ilinden”. Që sot, shkupjanët kanë mundësi të udhëtojnë nëpër bulevard modern, me dy korsi rrugore në çdo drejtim, gjelbërim të gjelbër, trotuare të rinovuara dhe korsi për biçikleta dhe ndriçim krejtësisht të ri. “Ilindenska”, u transformua në bulevard dhe hapi një korridor të ri rrugor që do të mundësojë qarkullim më të madh të automjeteve drejt lagjeve Karposh

dhe Gjorçe Petrov dhe në drejtim të kundërt, drejt qendrës së qytetit. Me këtë, u bë e mundur që automjetet të qëndrojnë më pak në këtë rrugë dhe kontribuuan për ndotjen më të vogël të ajrit – tha kryetari Trajanovski në hapjen e bulevardit.

Ai theksoi se në qendrën e qytetit nuk është zgjeruar asnjë bulevard në 12 vitet e fundit dhe se zgjerimi i rrugës “Ilindenska”, në bulevard është një projekt kapital për Qytetin e Shkupit.

- Në realizimin e tij investuam shumë punë dhe energji. Gjatë ndërtimit u ballafaquam me shumë probleme, të cilat i zgjidhëm me përkushtim dhe me sukses. Produkt i përpjekjeve tona është kjo rrugë moderne dhe e shpejtë në të cilën do të funksionojë korridor i gjelbër për lëvizjen e automjeteve – theksoi kryetari Trajanovski.



ZGJERIMI I RRUGËS "ILINDENSKA," NËPËRMJET SHIFRAVE

- Në pjesën e rikonstruktuar dhe të zgjeruar të bulevardit "Ilinden,, janë shtuar 22.700 ton asfalt. Përgjatë rrugës janë vendosur bordura me gjatësi të përgjithshme 6.000 metra, ndërsa nga ana e trotuareve janë vendosur bordura të vogla me gjatësi të përgjithshme 4.500 metra.
- Janë asfaltuar trotuaret dhe korsitë për biçikleta me sipërfaqe prej 7.200 metra katror, kurse me pllaka begatoni janë shtuar trotuare me sipërfaqe 3.100 metra katror. Janë asfaltuar 590 metra katror ishuj për këmbësorë.
- Në ndërtimin e bulevardit "Ilinden,, mesatarisht në ditë, punuan 150 punëtorë nga realizuesi „Granit“ dhe nga bashkëpunëtorët.
- Në punët përgatitore për zgjerimin e bulevardit "Ilinden,, u ndërtua kanalizimi atmosferik me gjatësi 2.313 metra dhe profil të ndryshueshëm, i cili është nga 400 deri në 1.000 milimetra. U sigurua edhe kullimi i dyanshëm i bulevardit. Përgjatë gjithë pjesës së zgjeruar janë vendosur 60 puseta dhe 105 vend derdhje për ujin atmosferik.
- Bulevardi "Ilinden,, ndriçohet nga 120 shtylla në të cilat janë vendosur 170 llamba ndriçuese të tipit ONIX 2 me fuqi nga 150 deri më 250 W nga firma Meinel Schroeder.
- Përgjatë bulevardit, nga kryqëzimi me bulevardin "Sv. Kliment Ohridski" deri në kryqëzimin me bulevardin "8.Sep-temvri" janë realizuar 9 semaforë. Janë vendosur 25 shtylla semafori konzol, 35 shtylla të zakonshme semafori, 95 lanterë për automjete dhe 76 lanterë për këmbësorë.
- Sinjalizimi rrugor horizontal është shënuar me bojë të bardhë dhe janë harxhuar rreth tre ton bojë. Janë vendosur 200 shenja rrugore.
- Përgjatë bulevardit "Ilinden,, është rregulluar gjelbërimi me bar me sipërfaqe 13.525 metër katror. Nga kryqëzimi me bulevardin "Sv. Kliment Ohridski" deri në kryqëzimin tek shatërvani "Lotosov cvet" janë mbjellë 66 drurë, kurse në pjesën nga shatërvani deri te bulevardi "8 Septemvri" – 78 drurë. Për ujitjen e gjelbërimit u realizua rrjeti hidrant me gjatësi 1.494 metra.
- Nga objekti Kopshti zoologjik deri në kryqëzimin me bulevardin "8 Septemvri" në pjesën e mesme të bulevardit "Ilinden,, janë ndërtuar zhardinier me sipërfaqe të përgjithshme 2.000 metër katror, për të cilët janë realizuar në mënyrë plotësuese 720 metra rrjet hidrant.
- Përgjatë gjithë gjatësisë së bulevardit janë rregulluar 20 stola dhe 50 kosha për mbeturina.
- Për realizimin e projektit për zgjerimin e bulevardit "Ilinden,, u realizua eksproprijimi me vlerë 20 milionë denarë. Për truallin e eksproprijuar janë ndarë tre banesa njëdhomëshe dhe një banesë me dy dhoma. U rrënuan krejtësisht tre objekte që gjendeshin në trasenë e bulevardit, kurse janë rrënuar pjesërisht katër objekte.

U LËSHUA NË PËRDORIM RRUGA E RIKONSTRUKTUAR “PRVOMAJSKA”



Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe kryetari i komunës Kisela Voda, Marjan Gjoçev, më 3 shtator zyrtarisht lëshuan në përdorim rrugën e rikonstruktuar “Prvomajska”, nga ura

“Markova reka” deri te fabrika OHIS. Rruga “Prvomajska” është riparuar në një gjatësi prej 2,5 kilometra, kurse për këtë projekt Qyteti i Shkupit ndau nga buxheti 14,5 milion denarë.

- Me këtë projekt ndërtimor zgjidhëm problemet shumëvjeçare të banorëve të shumë vendbanimeve në këtë pjesë të qytetit. Rruga “Prvomajska” ishte shumë e dëmtuar në këtë pjesë. Me rikonstruksionin e rrugës nga ura “Markova reka” deri te fabrika OHIS, ajo është zgjeruar dhe tani është 7 metra e gjerë. Sipërfaqja është asfaltuar dhe është shënuar sinjalizimi horizontal dhe vertikal – tha kryetari Trajanovski.

Në varësi të dëmeve të rrugës dhe konfiguracionit të terrenit gjatë muajit të kaluar në “Prvomajska” u realizuan punë ndërtimore të ndryshme – gërmim dhe gërryerje e shtresës së asfaltit të dëmtuar, shtrimi me shtresë asfalti të re AB 11 C. U harxhuan gjithsej 3.000 ton asfalt. Në terren punuan ekipet e HULUSI KOMERC – SHMPK Kumanovë.



U RINOVUA RRUGA “QEMAL SEJFULLA”

Në fund të korrikut u bë rikonstruksioni i plotë i rrugës “Qemal Sejfulla”, në lagjen e Çairit, gjë me të cilën u mundësua rritja e qarkullimit të automjeteve dhe u zvogëlua kaosi në qarkullimin rrugor në këtë pjesë të qytetit. Asfalti në këtë rrugë u rinovua në një gjatësi prej 800 metra. Rrugën e rinovuar e lëshoi në përdorim kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe kryetari i komunës së Çairit, Izet Mexhiti.

Për rikonstruksionin e plotë të rrugës “Qemal Sejfulla” Qyteti i Shkupit shpenzoi 11,4 milion denarë, kurse në rinovimin e rrugës punuan ekipet e kompanisë ndërtimore SHA. “Pelagonia-Gostivar”.

PËRFUNDOI RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS “FERID BAJRAM”

Ekipet e Qytetit të Shkupit përfunduan rikonstruksionin e rrugës “Ferid Bajram”. Rruga u rinovua në gjatësi 800 metra, u shtrua shtresë asfalti e re dhe u vendosën bordura të reja. Për rikonstruksionin e rrugës “Ferid Bajram” Qyteti i Shkupit shpenzoi 6,5 milion denarë.

- Rruga “Ferid Bajram” ishte e amortizuar dhe e dëmtuar plotësisht. Asfalti ekzistues u gërrye dhe rruga u shtrua me shtresë të re asfalti. Rikonstruksionin e rrugës “Ferid Bajram” arritëm ta përfundojmë për dy javë, shumë më parë sesa afati i parashikuar. Rikonstruksioni i rrugës “Ferid Bajram” kontribuoi për rritjen e sigurisë në qarkullim – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, i cili së bashku me kryetarin e komunës së Butelit, Petre Latinovski, e lëshuan në përdorim rrugën e rikonstruktuar “Ferid Bajram”.

Rikonstruksioni i rrugës “Ferid Bajram” u realizua nga ekipet e kompanisë së ndërtimit SHA: „Pelagonia – Gostivar”.



Start i suksesshëm i projektit për dhënien me qira të biçikletave

LËRE AUTOMOBILIN, NGIT BIÇIKLETËN !



АДСКИ ПАРКИНГ
(зади ТЦ Бисер)

ЦЕНА: 10 ден/час

Еко-свет
СКОПЈЕ
изнајма велосипед

Projekti për dhënie me qira të biçikletave për 10 denarë në orë nga tre punktet në sheshin „Maqedonia“, tek qendra tregtare „Biser“ dhe në parkingun publik „Treska“ zgjoi interes të madh tek qytetarët e Shkupit. Nga fillimi i projektit më 28 korrik deri tani numri më i madh i biçikletave të marra me qira është në punktin në sheshin „Maqedonia“.

Hapja e tre punkteve për dhënie me qira të biçikletave është faza e parë e implementimit të projektit për dhënie me qira të biçikletave nën moton „LËRE AUTOMOBILIN, NGIT BIÇIKLETËN“ që e realizon Qyteti i Shkupit. Qytetarët mund të marrin me qira 70 biçikleta për 10 denarë në orë në tre punktet e përmendura. Numri i stacioneve në të cilat mund të merret me qira biçikletë, pritet të rritet në të ardhmen, në varësi të interesit të qytetarëve.

Një segment interesant tek ky projekt është mundësia, se biçikleta e marrë me qira në një stacion, mund të kthehet në stacion tjetër. Për shembull, nëse shfrytëzuesi merr një biçikletë me qira nga stacioni i Aerodromit, mund ta kthejë në sheshin „Maqedonia“ ose, tek stacioni në parkingun publik „Treska“.

- Qyteti i Shkupit duke marrë parasysh pozitën e mirë gjeografike, e cila e radhit Shkupin në qytetet me kushte të shkëlqyera për ndërtimin e infrastrukturës për biçikleta, që përbën parakusht që biçikleta të jetë pjesë e ofertës si mjet transportues në qytet, në periudhën e kaluar punon në mënyrë aktive për të siguruar kushte për vendosjen e biçikletave si mjet transportues alternativ. Aktivitetet të cilat u realizuan në periudhën e kaluar, siç janë, shënimi i korsive për biçikleta dhe vendosja e lidhjes së pandërprerë të korsive për biçikleta ndërmjet pjesë lindore dhe perëndimore të qytetit, rinovimi dhe vendosja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal dhe vendosja e mbajtësve për biçikleta, na nxitën të mendojmë për përfundimin e projektit për promovimin e biçikletës si mjet alternativ transporti dhe kaluam në vendosjen e sistemit për dhënie me qira të biçikletave – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, në promovimin e Sistemit për dhënie me qira të biçikletave.



DITA NDËRKOMBËTARE PA AUTOMOBILA



Qindra nxënës, qytetarë, përfaqësues të Qytetit të Shkupit, Info-qendra e UE-së, Ministria për ambientin jetësor dhe planifikimin hapësinor dhe organizata joqeveritare më 22 shtator morën pjesë në paradën me biçikleta nga shatërvani në Parkun e qytetit nëpër bulevardin "Ilinden" dhe nëpër rrugët "Dame Gruev", "Maqedonia" dhe "Mito Haxhivasiliev Jasmin" deri te ambientet e Info-qendrës së Unionit Evropian, me rastin e Ditës ndërkombëtare pa automobila. Manifestimin e organizoi Qyteti i Shkupit, Info-qendra e Unionit Evropian, MAJPH dhe OJQ „Iniciativa të qëndrueshme“.

Qyteti i Shkupit e organizon tradicionalisht këtë manifestim dhe shënon Ditën ndërkombëtare pa automobila. Qëllimi i këtij manifestimi është të promovohet biçikleta si mjet transporti alternativ, të kontribuojë për ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm dhe të nxisë shprehi të shëndetshme për lëvizje dhe relaksim të qytetarëve. Qyteti i Shkupit në mënyrë të vazhdueshme punon në përmirësimin e rrjetit të korsive të biçikletave në qytet dhe nga muaji i kaluar qytetarët mund të marrin biçikleta me qira në suazat e projektit të qytetit „Lëre automobilin, ngit biçikletën“.

ASFALT I RI NË RRUGËN "IVAN KOZAROV"



Muajin e kaluar u shtrua me asfalt të ri rruga "Ivan Kozarov", në lagjen Kisela Voda. Kjo rrugë u rinovua në drejtimin nga kryqëzimi me rrugën "Dositelj Obradoviq" deri në kryqëzimin me rrugën "Bozhidar Axhi-ja", me gjatësi 340 metra.

Rruga u shtrua me shtresë të re asfalti me trashësi 5 centimetra dhe u harxhuan rreth 280 ton asfalt.

Për rikonstruksionin e plotë të rrugës "Ivan Kozarov" nga buxheti i Qytetit të Shkupit u dhanë rreth 3 milion denarë, kurse rikonstruksionin e realizuan ekipet e firmës së ndërtimit „Bauer BG“.

U ZGJERUA RRUGA "BELGRADSKA"



Rruga "Belgradska" në komunën Qendër është zgjeruar dhe rikonstruktuar plotësisht. Qyteti i Shkupit dhe NP „Rrugë dhe rrugica“ rinovuan rrugën nga kryqëzimi me rrugën "Vodnjanska" deri në rrugën "Dimitar Mitrev" me gjatësi 550 metra. Pas zgjerimit rruga është e gjerë gjashtë metra.

Me rinovimin e rrugës "Belgradska" u rrit qarkullimi i automjeteve dhe siguria në qarkullimin rrugor në këtë drejtim, kurse u zvogëlua ndotja e ambientit jetësor.

Qyteti i Shkupit për këtë punë shpenzoi rreth 5 milion denarë, kurse u shtruan 600 ton asfalt.

FILLOI RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS PËR KAMNIK



Rruga drejt varrezave Kamnik për dy muaj do të zgjerohet dhe do të shtrohet me asfalt të ri. Kjo degë e rrugës "Juzhnomoravski brigadi" është e gjatë 960 metra dhe me zgjerimin do të jetë 6 metra e gjerë.

Nga të dyja anët e rrugës do të ndërtohen trotuare me gjatësi dy metra, të cilat do të shtrohen me pllaka begatoni dhe mure mbështetëse nga ana e lagjes.

Kjo vepër ndërtimore është investim i përbashkët i Qytetit të Shkupit dhe komunës Gazi Baba me vlerë prej rreth 18 milion denarë, nga të cilat Qyteti i Shkupit do të mbulojë 13,7 milion denarë, kurse komuna Gazi Baba – 4,5 milion denarë. Zgjerimi dhe rikonstruksioni i rrugës do të lehtësojë lëvizjen banorëve në këtë pjesë të qytetit dhe të të gjithë qytetarëve që kanë nevojë të vizitojnë varrezat në Kamnik.

Në ndërtimin e rrugës për në Kamnik punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit „Bauer BG“.

Në rrugën "Juzhnomoravski brigadi" paraprakisht u realizua rrjeti i ri i kanalizimit atmosferik dhe fekal dhe gjithashtu u rinovua edhe rrjeti i ujësjellësit.

VOLEJBOLL NË RËRË NË PLAZHIN E QYTETIT

Në turneun miqësor në volejball në rërë, që nga data 22 deri më 25 korrik u mbajt në Plazhin e qytetit morën pjesë 28 garues në konkurrencën për meshkuj dhe femra, nga të cilët numri më i madh janë lojtarë të ekipit kombëtar të vendit tonë. Turneu u mbajt nën patronazhin e Qytetit të Shkupit dhe nën organizimin e Federatës së Volejbollit të Maqedonisë.



Në suazat e turneut në volejball në rërë u luajtën njëzet e dy ndeshje. Në konkurrencën për femra në vendin e parë u klasifikua Vlasta Ruzhinska dhe Branka Kalenikova, në vendin e dytë Sofka Kamilovska dhe Sandra Gjorgjiev-ska, kurse në vendin e tretë Maja Jakimovska dhe Elena Marovska.



Në konkurrencën për meshkuj kampionë të turneut të këtij viti janë vëllezërit Jovica dhe Dejan Simovski, vendi i dytë u takoi Goce Slavkov dhe Filip Despotoski, kurse vendi i tretë Viktor Zafirov dhe Vuk Karanoviq.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, çifteve më të suksesshme të volejbollit u ndau medalje dhe shpërblime në të holla.



SHKUPJANËT DO TË USHTROJNË NË BREGUN E LUMIT VARDAR



Në bregun e lumit Vardar, në afërsi të Plazhit të qytetit, kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe drejtori i Agjencisë për të rinj dhe sport, Dime Spasov, qytetarëve të Shkupit u dhanë zyrtarisht në përdorim disa punkte me rekuizitë sportiv për ushtrim dhe rekreacion. Punte të tilla ka edhe në urën „Bliznak“ në lagjen Aerodrom dhe tek hoteli „Aleksandar Palac“. Së shpejti pritet të përfundohen edhe disa punkte në ato vende ku ka më shumë nevojë për rekuizite të tilla gjimnastikore.

- Qyteti i Shkupit dhe Agjencia për të rinj dhe sport me realizimin e këtij projekti vetëm pasurojnë bregun e lumit Vardar me më shumë përmbajtje sportive që do të jenë në dobi të të gjithë atyre që merren me sport dhe rekreacion këtu - tha kryetari Trajanovski.

Projekti për puntet me rekuizite sportive është i Agjencisë për të rinj dhe sport, kurse investitorë janë Qyteti i Shkupit dhe NP „Rrugë dhe rrugica“.

Qyteti i Shkupit në korrik vendosi parkim zonal në parkingun pas qendrës tregtare „Mavrovka“. Parkingun disponon me 110 vende parkingu. Një orë parkim kushton 35 denarë, ndërsa automjetet mund të qëndrojnë më së shumti deri në katër orë.

Në komunën e Çairit për herë të parë vendoset parkimi zonal. Ky parking hyn në zonën për parkim B7. Banorët e ndërtesave përreth mund ta shfrytëzojnë parkingun për 200 denarë në muaj. Për parkimin e automobilit të dytë çmimi do të jetë 400 denarë në muaj. Firmat mund t'i lënë automjetet e tyre me çmim 3.000 denarë në muaj.

Sistemi i ri për parkim duhet t'ju ndihmoj qytetarëve të gjejnë më lehtë vend parkimi dhe do të ndihmojë në zvogëlimin e kaosit që krijohet në këtë vend me frekuencë më të madhe.



PARKIM ZONAL EDHE NË KOMUNËN E ÇAIRIT

U HAP PARKING I RI NËN QENDRËN TRANSPORTUESE

Qytetarët e Shkupit nga ky muaj mund të shfrytëzojnë parkingun e ri të hapur për automjete të lehta motorike, i cili gjendet nën Qendrën transportuese. Hapësira e parkingut të ri disponon me 218 vende të shënuara për parkim, ka sipërfaqe prej 6.840 metër katror dhe kufizohet me dy rrugë të reja të projektuara të cilat lidhin rrugët „Belasica“ dhe „Vladimir Komarov“.

Me parkingun menaxhon NP „Parkingu i qytetit“, kurse çmimi është 25 denarë në orë, pa kufizim për qëndrim. Parapagesa mujore për shfrytëzimin e parkingut është 2.000 denarë, kurse ajo vjetore 20.000 denarë. Banorët e ndërtesave përreth mund ta shfrytëzojnë parkingun për 250 denarë në muaj.

Baza e parkingut është e sheshuar, e tamponuar dhe e mbuluar me elementë pauer me trashësi 6 centimetra. Parapakisht, në këtë sipërfaqe është realizuar rrjeti për kanalizimin atmosferik dhe janë bërë vend derdhje. Në terren punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Begramo inzhenering“ dhe NP „Parkingu i qytetit“.

Rregullimi i kësaj hapësire parkingu lehtëson parkimin në këtë pjesë të qendrës në të cilën ka shumë objekte afariste dhe banesore. Për ndërtimin dhe rregullimin e parkingut Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 12 milion denarë.



U LËSHUA NË PËRDORIM RRUGA E ZGJERUAR "VOLKOVO"

7 metra. Është asfaltuar një sipërfaqe prej 11.900 metra katror. Në rrugë janë shënuar sinjalizimi horizontal dhe janë vendosur shenja të qarkullimit rrugor.

Për zgjerimin e rrugës "Volkovë" është bërë gërmimi me makineri, pjesa e rrugës është tamponuar, janë rregulluar bordurat dhe është bërë shtrimi me shtresë të re asfalti. Në pjesën ku është bërë rikonstruksioni, është realizuar gërryerja me makineri e asfaltit të dëmtuar dhe është bërë shtrimi me shtresë të re asfalti me trashësi 7 (shtatë) centimetra.

Qyteti i Shkupit për realizimin e projektit për rikonstruksionin dhe zgjerimin e rrugës "Volkovo" shpenzoi rreth 16 milion denarë.

Rruga "Volkovo", në lagjen Volkovë, muajin e kaluar u bë rikonstruksioni i plotë dhe u zgjerua nga hekurudha deri në qendrën lagjes, me gjatësi 1.700 metra. Me rikonstruksionin, rruga Volkovo" u zgjerua për 1,5 metra dhe tani është e gjerë

FILLOI DEPËRTIMI I PJESËS SË DYTË TË BULEVARDIT "MAKEDONSKA VOJSKA"

Punët ndërtimore për depërtimin e pjesës së dytë të bulevardit "Makedonska Vojska", në komunën Gjorçe Petrov, po zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar. Me ndërtimin e kësaj pjese e cila filloi muajin e kaluar do të depërtohen 800 metra të rrugës dhe do të ndërtohet rrugë e gjerë shtatë metra, me nga një korsi në çdo drejtim.

Përgjatë rrugës do të bëhen trotuare të cilat do të shtrohen me pllaka begatoni dhe do të vendoset edhe ndriçim i ri rrugor. Në terren punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit SHA. „Granit“. Për këtë veper kapitale Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 25 milion denarë.

Depërtimi i bulevardit "Makedonska Vojska" do të shfrytëzohet që të vendoset kanalizimi atmosferik përgjatë rrugës me profil 300, përkatësisht 400 milimetra, në varësi të kushteve të terrenit në të cilin zhvillohen punët ndërtimore.



U NDËRTUAN 320 METRA KANALIZIM FEKAL NË SINGELIQ



Nga kanalizimi i ri atmosferik i rrugës “Alija Avdoviq” e cila filloi të ndërtohet muajin e kaluar deri tanë janë përfunduar 320 metra. Rrjeti i ri do të shfrytëzohet për sistemin e ujërave fekale të fshatrave Stajkovci dhe Singeliq dhe një pjesë e lagjes “Metodija Andonov-Çento” që graviton drejt rrugës “Alija Avdoviq”.

Ky projekt përbën bashkimin e rrjeteve të kanalizimit të fshatrave Stajkovci dhe Singeliq. Kanalizimi i ri fekal i planifikuar është me gjatësi 745 metra dhe me profil 500 milimetra. Thellësia në të cilën do të realizohet rrjeti fekal do të jetë nga 2,40 deri në 3,50 metra, me përdorimin e tubave të betonit të armuar.

Ndërtimi duhet të përfundojë për katër muaj. Kanalizim fekal i ri është investim i plotë i NP “Ujësjellës dhe kanalizim” me vlerë 5,9 milion denarë, kurse në terren punojnë ekipet e firmës së ndërtimit „BEGRAMO DOO” nga Shkupi.



KANALIZIM ATMOSFERIK PËR BULEVARDIN “HRISTIYAN TODOROVSKI KARPOSH”



Kanalizimi atmosferik përgjatë bulevardit “Hristijan Todorovski Karposh” në lagjen Butel i cili filloi të ndërtohet në fillimin e këtij muaji do të zgjidhë në mënyrë të përhershme problemet me sistemin e ujërave nga reshjet dhe përmbytjet e rrugicave pas shirave të rrëmbyeshëm. Kanalizimi është me profil 800 milimetra dhe gjatësi 547 metra.

Me ndërtimin e kanalizimit atmosferik do të krijohen kushte për sistemin e plotë të ujërave fekale dhe atmosferike në dy kolektorë të veçantë, kurse ai ekzistues do të mbetet në funksion si kolektor për kanalizimin fekal.

U ZGJERUA KAPACITETI I STACIONARIT „VARDARISHTE“



ГРАД СКОПЈЕ
ЈП КОМУНАЛНА ХИГИЕНА
СТАЦИОНАР ВАРДАРИШТЕ
хуман шрејман и контрола

Kapaciteti i stacionarit për trajtimin human të qenve endacakë „Vardarishte“ nga muaji i kaluar është rritur dy herë. Ekipet e Qytetit të Shkupit përfunduan ndërtimin e objektit të ri që është pjesë e stacionarit dhe është ndërtuar sipas standardeve evropiane. Në të janë rregulluar tre stacionarë të dyfishtë me 12 bokse, të vendosura në 3 rreshta dhe 6 bokse të veçanta, të vendosura në dy rreshta ose gjithsej 48 bokse.

Bokset përbëhen nga një dhomë dite me dimensione 1,5 x 1,5 metra (të rrethuar me rretë metalike dhe derë) dhe dhomë gjumi me dimensione 1,5 x 1,10 metra (të ndërtuar prej blloqesh betoni, kurse në pjesën e përparme ka derë metalike). Gjatë kësaj janë respektuar komunikimet adekuate që mundësojnë lëvizjen e pandërprerë dhe pranimin e qenve.

Në objekt janë ndërtuar edhe një zyrë dhe magazinë me nyje sanitare, kurse parteri para stacionarit është shtruar me pllaka begatoni.

Qyteti i Shkupit për zgjerimin e stacionarit “Vardarishte” shpenzoi rreth 7 milion denarë. Aktivitetet ndërtimore i realizuan ekipet e kompanisë „ALKON“ nga Shkupi.

Zgjerimi i stacionarit „Vardarishte“ është pjesë e aktiviteteve që ndërmerr Qyteti i Shkupit në kontinuitet për zgjidhjen e problemit me qentë endacakë në Shkup dhe rritjen e kapacitetit për përkujdesjen dhe trajtimin human të tyre.



Shkruan Sasho Stefanovski

Të nderuar, ky është vizioni i cili po bëhet realitet vitet e fundit dhe shikohet në çdo hap, në çdo kënd të Shkupit tonë. Shkupi ndërtohet!

Në zgjedhjet lokale në vitin 2009 qytetarët e Shkupit i dhanë përkrahjen e tyre kandidatit të VMRO-DPMNE për kryetar qyteti dhe partive të koalicionit, zotit Koce Trajanovski, kurse lista këshilltare fitoi shumicën në Këshillin e Qytetit të Shkupit, përkatësisht morëm mandatin që ta bëjmë Shkupin vend shumë më të mirë dhe më të këndshëm për jetesë.

Ky është obligimi ynë ndaj qytetarëve të Shkupit sepse ata e meritojnë një gjë të tillë. E meritojnë që Shkupi të ngjasojë me qendrat e kulturës evropiane, metropolet evropiane, të cilat i lënë pa fjalë vizitorët për shkak të bukurisë së tyre jashtë kohore, ofertës kulturore dhe arritjeve të shumta arkitektonike.

Për fat të keq, Shkupi në të kaluarën ka kaluar nëpër shumë fatkeqësi në historinë e tij largët dhe të afërt. Nëpër rrugët e tij kanë kaluar pushtues të ndryshëm, secili në kohën e vet, ai është shkatërruar nga fatkeqësi elementare dhe natyrore, të cilat i morën mundësinë Shkupit që të krenohet

SHKUPI PO NDRYSHON, PO SHNDËRROHET NË METROPOL EVROPIAN!

me veprat arkitektonike të ndërtuara nga paraardhësit tanë.

Ne nuk mund ta parashikojmë të ardhmen, por mund të kemi vizion që do të përpiqemi ta realizojmë. Ne e kemi këtë vizion!

Duam që Shkupi të jetë një qytet i bukur dhe i zhvilluar ashtu si edhe metropolet evropiane. E duam Shkupin me bulevardë të mëdhenj e të gjerë, parqe të gjera dhe të mëdha, infrastrukturë të zhvilluar, ambient të pastër natyror, e duam Shkupin edhe me çuditë arkitektonike. Kjo është ëndrra!

Pikërisht këtë parashikua në programin tonë, vizionin tonë për Shkupin, me të cilin dolëm para qytetarëve. Ky është premtime që duhet ta realizojmë me rigorozitet.

Veprat infrastrukturore dhe projektet që filluan të realizohen vetëm disa muaj pas zgjedhjeve lokale në vitin 2009 do t'u mundësojnë qytetarëve të Shkupit dhe të gjithë atyre që vijnë në qytetin tonë, nervozë më të vogël gjatë lëvizjes nëpër rrugët e Shkupit.

Qyteti i Shkupit do të bëhet me dy bulevardë të rëndësishme, të cilët në një masë të konsiderueshme do të lehtësojnë jetën e bashkëqytetarëve tanë. Ai është bulevardi Serbia, i cili është në fazën përfundimtare, kurse bulevardi "Ilinden" do të lëshohet në përdorim kur Ju do ta lexoni këtë artikull. Kjo do të thotë rrjedhë shumë më relaksuese e qarkullimit në Shkup. Shkupjanët duhet të krenohen me të!

Por, nuk ndaluam këtu. Projekti ynë i ardhshëm është zgjidhja e qarkullimit rrugor për lagjen Kisela Voda, rruga "Prvomajska"

do të zgjerohet dhe bëhet bulevard, kurse do të fillojë të ndërtohet së shpejti dhe do t'u mundësojë 100.000 banorëve në këtë pjesë të Shkupit të arrijnë në mënyrë më të sigurt dhe komfore deri në destinacionet e tyre. Qyteti i Shkupit në këto 2 vjet investon edhe në drejtime të tjera rrugore nëpër të gjithë territorin e Qytetit të Shkupit, si dhe në infrastrukturën komunale.

Përfundimisht, Shkupi ka kryetar dhe Këshill që dinë të identifikojnë nevojat e Shkupjanëve.

Kur flas për punën e Qytetit nuk mund t'i lë pa përmendur ndërmarrjet publike, të cilat kanë rol kryesor në ndërtimin e përshtypjes për funksionimin e Qytetit. Me ardhjen e strukturës më të re drejtuese në ndërmarrjet publike, me qasje menaxhuese dhe përkushtim ndaj punës, ndërmarrjet publike të Shkupit dolën nga hija dhe u bënë motori kryesor në funksionimin e qytetit të Shkupit.

Pavarësisht nëse bëhet fjalë për higjienën, hapësirat e parkingut, furnizimin me ujë të pijshëm nëpër Shkup, rrugët e Shkupit apo gjelbërimin, ndërmarrjet publike kanë mundësinë të kontribuojnë për një Shkup më të mirë dhe ata me përkrahjen tonë e bëjnë një gjë të tillë.

Të nderuar, Shkupi po ndryshon! Po ndryshon qasja në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve të Shkupit, po ndryshon pamja e Shkupit me ndërtimet e reja dhe zgjidhjet qarkullimit rrugor dhe përfundimisht Shkupi po merr pamje evropiane.

Shkupi po ndryshon! Në të mirë...

QYTETI I SHKUPIT I PAJIS ME AUTOMJETE NDËRMARRJET PUBLIKE



Qyteti i Shkupit në periudhën e kaluar ka bërë furnizimin me një numër të madh automjete dhe mekanizim për nevojat e ndërmarrjeve publike për të mundësuar funksionimin më efikas të tyre:

- Ndërmarrja e qarkullimit publik „Shkup“ - 4 automjete (fugon, marka „Citroen“, nga të cilët tre janë të modelit „CITROEN JUMPER COMBI 30 L1H1 2.2HDI 100“, kurse njëra është e modelit „CITROEN JUMPER 4-40 L4H2 3.0HDI“).
- Ndërmarrja publike „Parqe dhe

gjelbërim“ - 5 automjete (një kamion, një automjet me vinç hidraulik, një mini ekskavator-ngarkues, një automjet të mesëm të rëndë me kabinë dhe një automjet – cisternë).

- Ndërmarrja publike „Higjiena komunale“ - 3 automjete (dy janë automjete terreni dhe një është automjet ngarkues).

- Ndërmarrja publike „Rrugë dhe rrugica“ - 8 automjete (dy automjete ngarkuese, dy automjete për shënimin e rrugëve, automjete për shtrimin e asfaltit, kompresor dhe rul).

U MIRATUA PROGRAMI PËR RIGJALLËRIMIN E DEPONISË SË MËPARSHME „VARDARISHTE“

Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e njëzeteshtatë të tij miratoi Programin për realizimin e projektit për rikultivimin dhe rregullimin e hapësirës në deponinë e mëparshme të qytetit „Vardarishte“. Me këtë përcaktohen volumi dhe aktivitetet konkrete, mjetet materiale dhe financiare dhe dinamika e realizimit të projektit për rikultivimin dhe rregullimin e hapësirës në deponinë e mëparshme të qytetit me sipërfaqe 41,7 ha.

Programi i miratuar do të realizohet në dy faza. Në fazën e parë do të bëhen hulumtime të ndryshme, projektme dhe procedura të tjera përgatitore, përderisa në fazën e dytë do të kryhen aktivitete operative për rregullimin e hapësirës. Aktivitetet e fazës së parë do të realizohen 12 muaj, kurse të fazës së dytë do të kapë një periudhë 24 mujore.

Me realizimin e këtij programi do të eliminohet rreziku nga shfaqja eventuale e zjarreve dhe eksploziveve, të shkaktuara nga prania e gazit deponik, pastrimi i ujërave nëntokësore dhe zvogëlimi i ndotjes në puset e ujit në Maxhari, si dhe mënjanimi i erës së pakëndshme që përhapet nga mbeturinat e deponisë. Pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, në territorin e deponisë së mëparshme „Vardarishte“ është parashikuar të ndërtohet park për rekreacion për qytetarët.

Për realizimin e këtij programi do të jenë të nevojshme rreth 8 milion denarë për realizimin e fazës së parë dhe 80 milion denarë për realizimin e fazës së dytë.



„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ „Shkupi“ u botua më:
10 dhjetor 2008

Kryeredaktor

Nedelço Krstevski

Redaksia

Seksioni për marrëdhënie me opinionin

Redaktor i fotografi së

Radomir Jovanoviç

Përkthyes dhe lektor

Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT

për botuesin
**Kryetari i Qytetit
Koçe Trajanovski**

Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon

02 3297 255

e-mail adresa

gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni:

Evropa 92 - Koçanë

NDËRTOHEN TROTUARE NË RRUGËN RAJONALE NË TRUBAREVO

Qyteti i Shkupit filloi ndërtimin e trotuarit dhe korsisë për këmbësorë përgjatë rrugës rajonale Shkup-Katlanovë (P- 303), nëpër vendin e banimit Trubarevo. Trotuari do të jetë i gjatë një kilometër, kurse i

gjërë dy metra. Përgjatë rrugës rajonale Shkup-Katlanovë trotuari dhe korsia për këmbësorë ndërtohen për herë të parë.

Me këtë ndërtim Qyteti i Shkupit zgjidh një problem serioz dhe shumë vjeçar

të banorëve të shumë vendbanimeve, të cilët i lidh kjo rrugë rajonale. Kjo pjesë vite me radhë përbën pikë të zezë qarkullimi në Shkup dhe vend në të cilin kanë ndodhur shumë aksidente rrugore. Korsia e re do të rrisë në mënyrë të ndjeshme sigurinë e këmbësorëve dhe të çiklistëve.

Përgjatë trotuarit dhe korsisë për këmbësorë këto ditë vendosen bordura të reja dhe do të bëhen edhe vend derdhje për ujërat atmosferik. Sipërfaqja e trotuarit do të tamponohet dhe do të shtrohet me pllaka begatoni.

Për ndërtimin e trotuarit dhe korsisë për këmbësorë në rrugën rajonale Shkup – Katlanovë, Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 3 milion denarë. Në terren punojnë ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“, kurse trotuari duhet të përfundojë për 30 ditë.



U RIPARUAN GROPAT NË RRUGËN “KOZLE”

Qyteti i Shkupit dhe NP „Rrugë dhe rrugica“ gjatë muajit në vazhdim do të riparojë gropat në rrugën “Kozle”.

Në këtë aksion u gërrye asfalti i dëmtuar dhe rruga u shtrua me shtresë të re asfalti. Për riparimin e gropave në rrugën “Kozle” u harxhuan rreth 154 ton asfalt.



U PASTRUA PLOTËSISHT KANALI PRZHINO

Sipas programit të Qytetit të Shkupit për mirëmbajtjen e kanaleve të hapura në territorin e qytetit për vitin 2010 ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“ këto ditë pastruan krejtësisht kanalën Przhino.

Pjerrësia dhe pjesa e brendshme e kanalit me sipërfaqe 1.600 metër katror u pastrua në mënyrë manuale dhe me mekanizim të përzier. Punëtorët, që punonin në mënyrë manuale në terren, me sharra prenë vegjetacionin e ulët, kurse me kazmë dhe shat gërmuan barin nga pjerrësitë dhe nga brendësia e kanalit. Në këtë aksion u përfshinë edhe makina skip dhe sharra motorike të tipit MS 250.

U ASFALTUAN SHUMË RRUGË NË SHUTO ORIZARI

Me kërkesë të qytetarëve të komunës Shuto Orizari, Qyteti i Shkupit bëri rikonstruksionin e plotë dhe asfaltoi rrugët „17“, „19“, „30“ dhe „33“. Kjo vepër ndërtimore zgjidh një problem të madh për banorët e kësaj komune të Shkupit.

Në aksionin e Qytetit të Shkupit për rikonstruksionin e rrugëve „17“, „19“, „30“ dhe „33“ në komunën Shuto Orizari janë asfaltuar gjithsej 4.000 metra. Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti shpenzoi rreth 12 milion denarë.

U HODH GUR- THEMELI PËR SALLËN SPORTIVE NË SHMQSH „ZEF LUSH MARKU“

Deri në fund të vitit duhet të përfundojë salla e re sportive në suazat e shkollës së mesme „Zef Lush Marku“. Salla sportive është pjesë e projektit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndërtimin e 145 sallave për shkollat e mesme dhe duhet të mundësojë zhvillimin e mësimin në lëndën e edukimit fizik.

Salla sportive është një objekt modern me sipërfaqe 1.300 metër katror dhe tribunë për 400 shikues. Salla do të jetë e pajisur me rekuizite për atletikë, gjimnastikë dhe për lojëra sportive. Ndërtimi saj do të kushtojë 40 milion denarë, mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Pas përfundimit të procesit mësimor në shkollë, nën kushte të parashikuara për të, salla do të mund të shfrytëzohet edhe nga qytetarët për sport dhe rekreacion.

PASTROHEN PJERRËSITË NË BREGUN E LUMIT VARDAR

Ekipet e Qytetit të Shkupit të cilët janë të obliguar për mirëmbajtjen e bregut të lumit Vardar gjatë muajit gusht në mënyrë manuale dhe makineri pastruan një sipërfaqe prej 31.000 metër katror. Pjerrësitë në bregun e majtë dhe të djathtë u pastruan me makineri dhe në mënyrë manuale në këto drejtime:

- nga ura tek Stacioni hekurudhor drejt bulevardit „Serbia“,
- nga ura për këmbësorë pas „Luna Park“ drejt klubit „Kajak Kanu“,
- nga ura për këmbësorë pas ndërtesës së Qeverisë drejt urës „Goce Delçev“,
- nga ura për këmbësorë pas ndërtesës së Qeverisë drejt urës pas „Luna park“.



Në territorin e komunës Saraj

U ZBULUAN 619 LIDHJE TË PALIGJSHME NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT



Gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë lidhje të paligjshme në rrjetin e ujësjellësit janë zbuluar deri tani nga ekipet e Qytetit të Shkupit, NP „Ujësjellës dhe kanalizim“ dhe komuna e Sarajit në aksionin për zbulimin, evidentimin dhe mënjanimin e lidhjeve të paligjshme në territorin e kësaj komune. Aksioni që filloi më 30 gusht gjeti në një jehonë pozitive nga të gjithë banorët e Sarajit dhe po zhvillohet pa ndërprerje, pa rezistencë dhe me intensitetin e duhur, në përputhje me dinamikën e parashikuar të NP „Ujësjellës dhe kanalizim“.

Ekipet që punojnë në terren janë të formuara nga të punësuar të NP „Ujësjellës dhe kanalizim“, kurse në punën e tyre

marrin pjesë edhe inspektorët komunalë të komunës së Sarajit, përfaqësues të komunës dhe të bashkësive vendore.

Deri tani në këtë aksion janë zbuluar 619 lidhje të paligjshme, nga të cilët 101 u mënjantuan nga rrjeti, paralajmërim kontrollues morën 92, kurse kontratë për furnizim me ujë lidhën 467 amvisëri.

Të gjitha amvisërive ku u zbuluan lidhje të paligjshme NP „Ujësjellës dhe kanalizim“ u ofroi të lidhin kontratë furnizimin me ujë ose t’u japë paralajmërim kontrollues. Me pranimin dhe nënshkrimin e paralajmërimit kontrollues amvisëria obligohet të vendosë ujë matës në afat prej 5 ditësh. Pas skadimit të afatit kryhet

kontroll dhe nëse ujë matësi është vendosur lidhet kontratë për furnizimin me ujë. Në të kundërt, nëse amvisëria nuk ka vepruar dhe akoma nuk ka vendosur ujë matës, inspektori komunal lëshon gjobë-mandat dhe kryhet mënjanimi nga rrjeti i ujësjellësit.

Aksioni zbatohet me rigorozitet dhe do të përfshijë gjithë territorin e komunës së Sarajit. Me këtë dinamikë realizimi aksioni do të zgjasë edhe 30 ditë. Pas përfundimit të tij ekipet e NP „Ujësjellës dhe kanalizim“ do të kryejnë kontrolle, veçanërisht në vendet ku janë zbuluar lidhjet e paligjshme, pikërisht atje ku janë bërë gërmimet dhe mënjanimet nga rrjeti i ujësjellësit.

Përveç dëmeve që i shkaktojnë infrastrukturës ekzistuese të furnizimit me ujë, lidhjet e paligjshme shkaktojnë edhe zvogëlimin e presionit të ujit në tuba, shfaqen vështirësi gjatë furnizimit normal me ujë në vendet më të larta të banuara dhe gjenërojnë edhe humbje të sasive shumë të mëdha të ujit.

Në park-pyllin Gazi Baba

KORSIA E MIQËSISË ME NATYRËN

Korsia për këmbësorë e gjatë 720 metra dhe e gjerë 1,90 metra këto ditë filloi të ndërtohet përgjatë kufirit të park-pyllit Gazi Baba, nga parkingu tek Shtëpia e shëndetit "Zhelezara" deri te terreni sportiv për fëmijë. Qyteti i Shkupit e ndërton këtë korsë me kërkesë të shoqatës civile të lagjes "Zhelezara" dhe të bashkësisë urbane "Zhelezara" dhe ajo do të mbajë emrin „Korsia e miqësisë me natyrën“.

Për ndërtimin e korsisë për këmbësorë është bërë gërmim me makineri i dheut për sheshimin e terrenit, korsia është tamponuar dhe po asfaltohet me masë asfalti BNS-16.

Në ndërtimin e korsisë dhe në pastrimin e terrenit u përfshinë ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“ dhe „Parqe dhe gjelbërim“. Qyteti i Shkupit për ndërtimin e saj shpenzoi rreth një milion denarë. Korsia është e ndriçuar me kandelabra.

PAMJE E RE E RRUGËS "VASIL GJORGOV"

Qyteti i Shkupit filloi rikonstrukcionin e rrugës "Vasil Gjorgov", e cila do të shtrohet me asfalt të ri nga kryqëzimi me bulevardin "Vodnjanska" deri te qendra tregtare e vjetër në Kapishtec, kurse vetë kryqëzimi do të zgjerohet që të mundësohet qarkullim më i madh i automjeteve. Punët ndërtimore për rinovimin e kësaj rruge frekvente i kryen kompania ndërtimore „Bauer BG“.

Paraprakisht, në pjesën e bulevardit "Vodnjanska" deri te ndërtesa e „Zhito Luks“, në gjatësi prej 300 metra, u vendos kanalizim atmosferik. Kanalizimin e ndërtuan punëtorët e „Bergamo“.

Sipas projektit për rikonstrukcionin e rrugës "Vasil Gjorgov" do të rinovohen trotualet nga të dyja anët e rrugës, të cilat do të shtrohen me elemente pauer.

Rinovimi i rrugës "Vasil Gjorgov" kushton rreth shtatë milion denarë, nga të cilat 3,5 milion denarë siguroi Qyteti i Shkupit.



Më 1 shtator Trajanovski mori pjesë në orën e parë të mësimin në shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit „Josip Broz Tito“.

- Ju nxënësit e shkollave të mesme – Ju bëni zgjedhjen tuaj e cila përcakton rrugën tuaj drejt suksesit personal dhe të përgjithshëm dhe progresit. Arsimi është forca që Ju hap horizonte dhe pamje të reja. Dija është themeli në të gjithë atë proces që lëviz përparimin e njeriut dhe njerëzimit, themel i shkencës që lëviz jetën përpara dhe mundëson perspektivën e saj. Procesi i përvetësimit të dijeve nuk është as i thjeshtë as i lehtë. Ai kërkon përpjekje

DITA E PARË E SHKOLLËS NË VITIN SHKOLLOR 2010/2011

Në emër të Qytetit të Shkupit dhe në emrin e tij kryetari Koce Trajanovski u uroi fillimin e vitit të ri shkollor të gjithë nxënësve të shkollave të

mesme dhe i porositi të besojnë në vetvete dhe se vitet që do të kalojnë në bankat shkollore do t'u sjellin sukses personal dhe shumë dije të reja.

të veçanta, durim dhe këmbëngulje. Ky proces kërkon përkushtim dhe sakrificë – i porositi nxënësit e shkollave të mesme kryetari Trajanovski.

U NDËRTUA MINI TERREN PËR ATLETIKË NË SHKOLLËN E MESME „ARSENIJ JOVKOV“

Javën e kaluar në shkollën e mesme „Arsenij Jovkov“ u ndërtua një mini terren për atletikë, pikërisht korsi për kërcim së gjati, korsi për atletikë dhe platformë dhe terren për hedhjen e gjyles. Për ndërtimin e terrenit Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 800.000 denarë.

Terreni i atletikës është ndërtuar në oborrin e shkollës. Ndërtimi i korsisë për kërcimin së gjati u zhvillua në disa faza. Së pari u krye gërmimi me makineri i dheut dhe u vendos tampon, kurse pastaj korsia për të marrë vrull e gjatë 32 metra dhe e gjerë 1,25 metra është shtruar me dhe të kuq. Gropa, e cila është e shtruar me rërë është me gjatësi 10 metra dhe gjerësi 3 metra, është e kufizuar nga të gjitha anët me bordurë.

Platforma për hedhjen e gjyles ka podium betoni me diametër 1,25 metra, kurse në terrenin prej 30 metra katror është vendosur zhavorr i bardhë.



Korsia e atletikës është me gjerësi 5 dhe gjatësi 70 metra, kurse sipërfaqja e përgjithshme e shtruar me dhe të kuq është 350 metër katror. Përgjatë gjithë

gjatësisë së korsisë janë vendosur bordura.

Në ndërtimin e terreneve për atletikë punuan ekipet e NP „Rugë dhe rrugica“.

Qyteti i Shkupit nga data 11 deri më 25 korrik të këtij viti, për herë të dytë, ishte nikoqir i ekspeditës evropiane të zhytësve të shpellave „Vrelo 2010“, e udhëhequr nga zhytësi i shpellave Luixhi Kasati nga Italia dhe Mark van der Mullen nga Belgjika. Kasati dhe Van der Mullen me përkrahjen e ekipeve të tyre, këtë vit në hulumtimet e tyre e kaluan thellësinë prej 190 metra të arritur gjatë ekspeditës së vitit të kaluar dhe në shpellën Vrelo hyn në thellësi prej 212 metra, që përbën thellësinë e dytë në Evropë dhe të parën në Ballkan.

Ky eveniment është nën organizimin e klubit të zhytësve të shpellave „Vrelo“ nga Shkupi, kurse Qyteti i Shkupit me përkrahje financiare prej një milion denarë është sponsori gjeneral i ekspeditës evropiane të zhytësve të shpellave „Vrelo 2010“.

LUIXHI KASATI ARRITI DERI NË 212 METRA THELLËSI NË SHPELLËN VRELO

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski përshëndeti ekspeditën dhe shprehu falënderimin e tij për hulumtimet e tyre në shpellën nënujore „Vrelo“ dhe promovimin e saj si një nga shpellat nënujore më të bukura dhe më të thella në botë.

- Shfrytëzoj rastin të ftoj zotin Luixhi Kasati të vijë edhe vitin tjetër dhe të përpiqet të thyejë rekordin evropian. Qyteti i Shkupit edhe vitin e ardhshëm do ta përkrahë nga ana financiare ekspeditën – deklaroi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

Kasati, theksoi se shpella „Vrelo“ përbën një sfidë të vërtetë për hulumtim për shkak të korridoreve të shumta të pa hulumtuara që ka, sepse në thellësinë 212 metra kishte vërejtur se shpella ndahet në dy pjesë. Në të njëjtën kohë, Kasati vuri theksin edhe në aspektin ekologjik të hulumtimeve.

- Ne konsiderojmë se shpella ka burim uji. Në suazat e ekspeditës hulumtuese „Vrelo 2010“ janë marrë ekzemplarë nga uji dhe sedimente dhe me analizat e tyre mund të merren rezultate interesante – tha Kasati.

Qyteti i Shkupit për nevojat e ekspeditës nëpërmjet Ministrisë për Punë të Brendshme siguroi helikopter, me ndihmën e të cilit u kompletuan xhirimet që do të përdoren në filmin dokumentar për kanionin e Matkës dhe shpellën nënujore Vrelo.



KOLONIA E PESTË NDËRKOMBËTARE

Në koloninë e sivjetme të artit figurativ „Shkupi 2010“, e cila për dhjetë ditë nga fundi i gushtit u mbajt në hotelin „Arka“, morën pjesë 10 piktorë nga vendi dhe jashtë vendit, me temë „Shkupi“ këtë radhë krijuan Goce Bozhurski, Sasho Popovski, Robert Cvetkovski, Julijana Geshoska dhe Shqipe Mehmeti nga Maqedonia, Sandrine Brisier nga Parisi, Francë, Berna Erkun nga Stambolli, Turqi, Momçilo Macanoviç nga Tivati, Mali i Zi, Narcis Kantarxhiq nga Celje, Slloveni dhe Slavica Marin nga Umag, Kroaci. Kolonia u organizua nën patronazhin e Qytetit të Shkupit. Tradicionalisht, pjesëmarrësit në koloni janë artistë nga qytetet e vëllazëruara, si dhe nga qytete me të cilat Qyteti i Shkupit në të kaluarën ka vendosur bashkëpunim kulturor. Veprat e piktorëve, për publikun e gjerë, do të paraqiten në Muzeun e qytetit të Shkupit më 13 nëntor të këtij viti, me rastin e festimit të Ditës së çlirimit të Shkupit.



▲ Sasho Popovski (Maqedoni)



▲ Slavica Marin (Umag, Kroaci)

-Njëherë isha në Shkup dhe jam e lumtur për takimin e dytë me qytetin. Gëzimi më i madh është shoqërimi me njerëzit. Shkupi është qytet i shkëlqyer. Isha e befasuar në mënyrë të këndshme nga skulpturat, Çarshia, këtu gjithçka është e bukur. Erdha e gëzuar, akoma më e gëzuar do të kthehem.....



▲ Momçilo Macanoviç (Tivat, Mali i Zi)

-Në Shkup jam për herë të parë. Si mysafir i kolonisë kisha kohë dhe mundësi të shikoj qytetin, të vizitoj shumë muze dhe galeri. Më pëlqen qyteti, i ngjan një qendre moderne, keni piktorë me kualitet dhe popull shumë mikpritës. Do të desha përsëri të vij këtu.....



▲ Julijana Geshoska (Maqedoni)

▼ Narcis Kantarxhiq (Celje, Slloveni)

-Unë në një farë mënyre, jam i lidhur me Shkupin, kurse shkak kryesor që erdha



këtu, janë kujtimet e shumta që më lidhin me Maqedoninë. Tërmetin e mbijetova këtu në Shkup, gjyshja ime është maqedonase, kurse teza jetonte në afërsi të Daut Pasha Amam. Këtu rreth OBM, më kujtohet, si fëmijë, shëtisja me biçikletë. Tani, më pëlqen që Shkupi është një qytet kaq i madh, kurse njerëzit kanë ruajtur temperamentin ballkanik të jetesës. Për herë të fundit në Shkup isha para tetëmbëdhjetë vitesh, por shpresoj se do të vij edhe më 13-Nëntor kur do të organizohet ekspozita e pikturave të kolonisë.

E ARTIT FIGURATIV „SHKUPI 2010“



◀ **Goce Bozhurski (Maqedoni)**

- Faza kur përjetohet Çarshia e Vjetër e Shkupit si një vend etno-folklorik, mendoj se ka kaluar tashmë dhe se tani kjo pjesë e qytetit u bë disi më lirike.. Shkupi si mjedis urban ofron më shumë mundësi në lidhje me qytete e tjera nga brendësia. Unë jetoj në Kumanovë, por çdo ditë udhëtoj deri në Shkup. Jam skeptik në lidhje me kolonitë, por Çarshia e Vjetër e Shkupit u tregua si një recetë e mirë, sepse ofron një farë kontakti të drejtpërdrejtë....



▲ **Shqipe Mehmeti (Maqedoni)**

- Unë kam lindur në Kërçovë, por për shkak të studimeve dhe punës tani jetoj në Shkup. Është shumë interesante se kur fillova të studioj këtu, nuk mendoja se ky do të jetë qyteti në të cilin do të jetoj, por tani kur do të shkoj për disa ditë në Kërçovë, me të vërtetë më mungon Shkupi....



▼ **Berna Erkun (Stamboll, Turqi)**

- Shkupi më pëlqeu shumë. Edhe vendi im ka kulturë dhe senzibilitet të ngjashëm me tuajin. Më pëlqeu pjesa e vjetër e qytetit, më pëlqeu arkitektura dhe modestia e Shkupit. Si dy qytete të ndryshme të përziera në një, më pëlqyen ngjyrat e Shkupit, disi toke, të ngrohta. Shkupi është një qytet i qetë dhe koha është më e mirë këtu. Paraardhësit e babait tim janë me origjinë nga Maqedonia, prandaj gjithmonë më ka interesuar vendi juaj

◀ **Robert Cvetkovski (Maqedoni)**

-Jetoj në Kriva Palanka, por me Shkupin më lidhin kujtime shumë të bukura, studimet, kolegët, miqtë. Kohëve të fundit, në Shkup vij vetëm kur më provokon ndonjë eveniment, sepse kjo është qendra e evenimenteve në Maqedoni. Deri tani kam qenë në 40-të koloni në vend dhe jashtë vendit, por për herë të parë jam pjesëmarrës në koloninë „Arka“ dhe gjithmonë është mirë kur njih njëzet të rinj dhe përjeton eksperiencën të reja.....



▲ **Sandrine Bridier (Paris, Francë)**

-Për mua përshtypja e parë për qytetin tuaj është me të vërtetë e çuditshme, një ndjenjë disi e papritur kënaqësie. Jam e lumtur këtu në Çarshinë e Vjetër të Shkupit dhe gëzohem që duke shëtitur nëpër rrugicat e saj kisha mundësi ta njoh më mirë. Pikturat e punova këtu në hotel, kurse inspirimin e merrja duke shëtitur pa pushim nëpër Shkup dhe duke vizituar kishat e shumta.....



MATINE TRADICIONALE E MATKËS



Duke recituar në gjuhën maqedonase vargjet e krijimit të parë „Dhurata“, poeti dhe autori i vjershës, Todor Çalovski, më 24 gusht hapi Matinen poetike tradicionale që mbahet çdo vit në sheshin para manastirit „Shën Andrea“ në liqenin e Matkës. Matinea poetike realizohet në suazat e festivalit të 49-të të Mbrëmjeve të Strugës, nikoqir është Qyteti i Shkupit, kurse organizimi nën patronazhin e kryetarit të Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

- Nëpërmjet Matines poetike, adhuresit e fjalës së mirë dhe poezisë, por edhe qytetarët e Shkupit, kanë një mundësi të rrallë të dëgjojnë vargje nga poezi të recituara nga vetë poetët nga të gjitha meridianët. Jam i bindur se dhe sot vargjet e recituara do të kumbojnë me të njëjtën fuqi dhe zjarr, siç kumbon në bregun e lumit Drin në Strugë, ditët e fundit. Jam i sigurt se, kanioni Matka, i njohur për nga bukuria e vet natyrale, me monumentet e kulturës, me florën dhe faunën endemike dhe shpellat e mirënjohura, mund të jetë po aq inspirues për imagjinatën krijuese si lumi Drin dhe liqeni i Ohrit – theksoi kryetari Trajanovski.

Në takimin tradicional poetik të Matkës këtë vit kishte poetë nga Japonia, Australia, Estonia, Egjipti, Franca, Italia, Kina dhe vende të tjera, kurse kryetari i Shoqatës së shkrimtarëve të Maqedonisë, Danilo Kocovski, shfrytëzoi mundësinë t'u shprehë falënderimet të gjithë mysafirëve të pranishëm të Mbrëmjeve të poezisë të Strugës edhe për krijimet që kanë shkruar si rezultat i inspirimit të tyre nga vendi ynë, dhe që i lënë si trashëgimi poetike në Maqedoni.

FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I 35-TË -TRH 2010

Njëzet shfaqje teatrale në produksionin e teatrove nga Franca, Sllovenia, Kroacia, Bullgaria, Luksemburgu, Romania, Lituania, Danimarka dhe nga Maqedonia ishin pjesë e Festivalit ndërkombëtar të teatrit të 35-të – TRH 2010. Festivalin jubilar të TRH-së e hapi shfaqja „Mbreti vdes“, bashkëpunim ndërmjet disa festivaleve evropiane (Francë, Slloveni, Luksemburg, Romani dhe Maqedoni), me regji të Silvio Purkarete.

Teatri rinor i hapur i këtij viti u realizua në nëntë mbrëmje, në disa skena teatrale në kinemanë „Frosina“ në QKR, në Operën dhe baletin maqedonas dhe teatrin „Qendër“, si dhe në skenën e Teatrit dramatik. Tradicionalisht, në garën për çmimet e festivalit

për shfaqjen më të mirë në tërësi hynë shfaqjet e produksioneve të jashtme, kurse „Ëndrra e natës verore“ e Teatrit të qytetit të Vilnosit, nga Lituania, u shpall si më e mira në festivalin e sivjetmë të TRH-së. Shfaqja është me regji të Oskaras Koorshunovas sipas tekstit të Wiliam Shekspir dhe produksion i OKT-Teatrit i qytetit të Vilnosit, Lituani.

Me rastin e festimit të jubileut, u ndanë edhe dy pllakate nderi ari „Sllovensko mladinsko gledalishçe“ dhe Ljubisha Nikodonovski-Bish, themelues i TRH-së. Në suazat e Festivalit u realizuan edhe disa aktivitete programore siç janë punëtoritë „Të jesh kritizer“, „Aktivitete në kontekst“ dhe „Guxo të ëndërrosh“.


Juria e festivalit ishte me përbërje: Liljana Mazova, kritik teatri, Ivan Xheparovski, estet dhe profesor në Fakultetin filologjik në Shkup dhe Natasha Avramovska, teatrolog. Drejtori artistik i TRH-së është regjisori Dejan Projkovski, kurse seleksionues i programit maqedonas është aktori Dejan Liliq. Festivali ndërkombëtar i teatrit i tridhjetepeshtë - TRH 2010 përfundoi më 26 shtator me dy shfaqjet e „Sllovensko mladinsko gledalishçe“: „Mallkuar qoftë tradhtari i vendit të vet“ dhe „Dashuria ime“.

Sponsorë të Teatrit rinor të hapur janë Qyteti i Shkupit dhe Ministria e kulturës, kurse organizator dhe realizues është Qendra kulturore rinore - Shkup.



„TINGUJT E ÇARSHISË“

PËR HERË TË PESTË



Ekspozita, koncerte, performansa, shfaqje folklorike dhe prezantimi i zanave të vjetra dhe krijimeve me dorë ishin pjesë e programit të pasur multikulturor dhe multimedial që nga data 14 deri më 15 shtator tërhoqi vëmendjen e banorëve të Shkupit në manifestimin „Tingujt e çarshisë“ për të pestën herë me radhë. Karakteri i këtij manifestimi ka për qëllim të rigjallërojë traditat e vjetra dhe të harruara në Çarshinë e Vjetër të Shkupit dhe t'i japë impuls rigjallërimit të saj dhe rianimitit nëpërmjet hapjes së portave të artit dhe kreativitetit.

Qyteti i Shkupit themeloi manifestimin „Tingujt e çarshisë“ në vitin 2006, si një nga aktivitetet për animimin kulturor dhe rigjallërimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit, si dhe për promovimin e saj turistik.



NË "PIVOLEND 2010" U PINË 200 TON BIRRË



Rreth 400.000 qytetarë të Shkupit ishin mysafirë të festivalit të tretë "Pivolend 2010" me birrë në Shkup, që u mbajt në Kalanë e Shkupit dhe në Çarshinë e Vjetër të Shkupit. Numri i vizitorëve në këtë festival të birrës ishte katër herë më i madh, që "Pivolend 2010" e bën evenimentin më masiv në vendin tonë. Vizitorët e "Pivolend 2010" të tretë kishin mundësi të degustojnë pesëdhjetë lloje birrash dhe pinë rreth, 200.000 litra birrë dhe 500 hektolitra lëngje dhe ujë.

Në pesë netët e festivalit, në 7 podiume, morën pjesë rreth 50 grupe muzikore vendase dhe nga jashtë, artistë dhe dixhej, kurse në suazat e 60-orëve të shoqërimit me birrë rreth 150.000 persona degustuan një pjesë nga specialitetet e disa brendeve të ushqimit, të cilat pasuruan ofertën e kësaj Fundjave me birrë.

Në suazat e festivalit të birrës, organizatorët e "Pivolend 2010" në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Qytetit të Shkupit realizuan fushatën për siguri në qarkullimin rrugor pa alkool me moton "KUR PINI, MOS NGISNI MAKINËN-KUR NGISNI MAKINËN, MOS PINI!"

Viti i tretë me radhë i manifestimit "Fundjave lakmuese me birrë në Shkup" u mbajt nën parullën „Erdha, shikova, piva“ dhe nën organizimin e Qytetit të Shkupit, Sektorit për zhvillim ekonomik lokal në bashkëpunim me „Shoqërinë civile – Pivolend Shkup“. Manifestimi përfundoi me 19 shtator.



MBI 2.000 QYTETARË HËNGRËN MËNGJES NË URËN E GURIT



Mbi 2.000 qytetarë të Shkupit, mysafirë dhe turistë të dielën, më 19 shtator, hëngrën mëngjes në Urën e Gurit dhe morën pjesë në manifestimin e qytetit „Mëngjes në urë“ i cili këtë vit u mbajt për herë të parë. Qëllimi i këtij shoqërimi, të cilin e organizon Qyteti i Shkupit është që të kremtohet emri Shën. Marisë – mbrojtëses së qytetit të Shkupit dhe pritet që ky manifestim të bëhet një traditë. Vendi është zgjedhur për një arsye të vetme – Ura e Gurit është simboli i Shkupit.

Qyteti i Shkupit në këtë mënyrë modeste do që të afrojë të gjithë qytetarët e Shkupit dhe t’ju tregojë si t’i respektojnë vlerat tradicionale. Në mëngjesin e përbashkët morën pjesë edhe kryetari Koce Trajanovski, i cili u dëshiroi ushqim të këndshëm.



Në Urën e Gurit nga njëra anë ishin vendosur stenda me ushqim dhe me pije nga donatorët, kurse në anën tjetër rrinin qytetarët e Shkupit, të cilët kishin mundësinë e rrallë të shijojnë një pjesë të specialiteteve të „Tineks“, „Zhito Luks“, „Zhito Vardar“ - Veles, të Kafenesë „Pelister“, „Vitaminska“ dhe shumë prodhues të tjerë të ushqimeve dhe pijeve nga Maqedonia.

Për dy orë muzikantët e rrugës të Shkupit i zbavitën qytetarët që erdhën për të ngrënë mëngjesin së bashku.

Ky manifestim është nën organizimin e Qytetit të Shkupit, nën patronazhin e kryetarit të Qytetit të Shkupit, kurse si partnerë direkt u përfshinë Dhoma e artizanëve të Qytetit të Shkupit dhe shkolla hoteliere SHMQSH „Lazar Tanev“ - Shkup.

„WORLD CYBER GAMES“ NË SHESHIN „MAQEDONIA“

Në sheshin „Maqedonia“ më 21 gusht të këtij viti u mbajtën garat kombëtare kualifikuese për kampionatin botëror në e-sport, „WORLD CYBER GAMES“. Garat zgjatën dy ditë dhe në to morën pjesë mbi 550 të rinj nga e gjithë Maqedonia. Përveç garave për shkathtësitë e të rinjve pjesëmarrës, qëllimi i saj është edhe promovimi dhe edukimi për përparesitë e shfrytëzimit të softuerit legal, veset moderne dhe si të ballafaqohemi me ta.

Në 5 vitet e kaluara, e-sporti në Maqedoni përjetoi një rritje dhe zhvillim të vërtetë, paralelisht me zhvillimin në nivel botëror.

- Shpresoj se e-sporti në të ardhmen do të popullarizohet sa më shumë dhe më të mirët nga vendi ynë, përkatë-

sisht përfaqësuesja jonë në e-sport, në kampionatin botëror të sivjetmë që do të mbahet në SHBA, por edhe në kampionatet e ardhshme botërore, të arrijë rezultate të mira, gjë me të cilën do të jetë ambasador i vendit tonë nëpër botë – tha kryetari Trajanovski.

Ai bëri me dije edhe përkrahjen financiare të këtij manifestimi në të ardhmen.

Këtë vit kampionati botëror i WCG do të mbahet në Los Anxhelos dhe fituesit në garat kualifikuese në e-sport, në fakt, janë anëtarët e – përfaqësueses së Maqedonisë.

HITET MË TË REJA BOTËRORE FILMIKE NË „MILENIUM“

Në tetor, repertori i Kinemasë së qytetit „Milenium“, do të plotësojë shijet e dashmirëve të artit të shtatë, duke shfaqur hitet më të reja filmike botërore. Në zemrën e vjeshtës publiku filmik do të shikojë projeksionet e filmave: Gënjeshtra të virgjëra (Knight and day) me regji të Xhejms Mengold me Tom Kruz, Kameron

Dijaz dhe Piter Sargard në rolet kryesore; Nxënësi i magjstarit (The Sorcerer's Apprentice), film i regjisorit Xhon Turtiltob dhe Nikolas Kejxh, Monika Beluçi, Alfred Molina dhe Xhej Barukel në rolet kryesore; Sol (Salt), me Anxhelina Xholi, Daniel Ombrihski dhe Liev Shrejber, me regji të Filip Nojz; A – Tim (The A-Tim), me regji të Xhon

Kalahan, me Lijam Nison, Bredli Kuper, Kuinton Xhekson dhe Sharlito Kolpi; megahiti Wall street: Paratë asnjëherë nuk flenë / Wall street 2 (Wall Street: Money Never Sleeps / Wall Street 2) i fituesit të çmimit Oskar Oliver Stoun me Majkl Douglas, Çarli Shin, Keri Maligan dhe Shija Labuf në rolet kryesore, Tregim për lojërat (3 Toy story 3), film i animuar për adhuruesit e vegjël të filmit, me regji të Lee Unkriç, me zërat e huanuar të aktorëve Tom Hens, Tim Alen dhe Xhoan Kjukzak dhe Vranësirë me mundësi për reshje qoftesh (Cloudy With A Chance Of Meatballs), film në të cilin rolet kryesore i luajnë Bil Hader, Ana Faris, Xhejms Kan, kurse filmi është produkt i çiftit kreativ të regjisorëve Fil Lord dhe Kris Miler.

Biletat për këta filma mund të blihen në biletarinë e kinemasë. Kinemaja „Milenium“ për të gjithë adhuruesit e këtyre block-baster, për shikim në grup, ofron çmimin prej 80 denarë për biletë.





Rekuzite sportive në bregun e lumit Vardar